



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1107/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, për shkak të parregullsive në ditën e votimit në raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me datë 19.11.2017, në seancën e panelit të datës 22.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren, me shenjën ZL.Anr.1107/2017, të datës 20.11.2017, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, për shkak të parregullsive në ditën e votimit në raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me datë 19.11.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me ZL.Anr.1107/2017 me datën 20.11.2017, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren, me të cilën ka pretenduar se në Qendrën e Votimit nr.2004 A në Shkollën “Motrat Qiriaz” në Lagjen Kurillë në Prizren në vendvotimet: 2004A/03r, 2004A/05r, 2004A/06r, 2004A/07r, ka ndodhur shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjit për Zgjedhjet Lokale dhe Rregullave Zgjedhore të KQZ-së. Në ato vendvotime ka pasur presion ndaj votueseve, prezencë të personave të paautorizuar para Qendrës së Votimit dhe brenda në QV., lejim të votimit të personave në emër të personave tjerë, fotografim të votës, si dhe gjatë pranimit të materialit në KKZ është vërejtë dëmtim i kutive të votimit të kësaj qendre dhe ndërhyrje në Formular të Rezultateve-FPR. Në vendvotimin 2004A/06r, nga vëzhguesja Sevim Budakova, ka marr informata se janë lejuar persona që të votojnë në emër të personave tjerë, ka parë një votuese e moshës së re duke votuar në emër të një të moshuarë dhe se komisioni i venvotimit nuk i ka lënë të shohin të dhënat personale të moshuarës në listën e votueseve. Po ashtu e njëjta vëzhguese ka raportuar se ka pasur raste të fotografimit të votës dhe kjo i ka bërë të dyshojnë se ka pasur blerje të votës si dhe fotografimi i votës për të dëshmuar votën e tyre. Edhe në vendvotimin 2004A/03r, vëzhguesi Besfort Beshi nga Prizreni, ka raportuar se ka pasur presion ndaj votueseve dhe ndërhyrje në procesin zgjedhor, votim me asistencë, të cilët

nuk janë të regjistruar me emër dhe mbiemër sipas ligjit dhe nuk janë të evidentuar në librin e votimit. Po ashtu në FPR ka ndërhyrje në formular, si dhe ka mospërputhje në ata formular. Në vendvotimin 2004A/05r ka ardh në KKZ kutia me shirita të hapur që i bënë të dyshojnë se ka pasur ndërhyrje në rezultatin zgjedhor si dhe në këtë vendvotim ka pasur edhe votim të dyfishtë, votim familjar dhe shkelje tjera.

Gjithashtu vëzhguesit gjatë tërë ditës kanë vërejtur persona të paautorizuar para qendrës së votimit të cilët kanë ndikuar në votues dhe kanë bërë presion dhe ndikim në përcaktimin e lirë të votueseve. Këta persona janë aktivist të LVV dhe NISMES (Fatmir Zeka, Avni Krasniqi, Naim Tale, kanë qenë tërë kohën para shkollës dhe në ambientet e saj). Andaj subjekti politik PDK ka kërkuar nga PZAP, që të hetoj nënshkrimet në listen përfundimtare të votueseve dhe materialet tjera zgjedhore në vendvotimet e Qendrës së Votimit 2004 A në Shkollën “Motrat Qiriazit” në Prizren, të anulohen rezultatet vendvotimeve të Qendrës së Votimit nr.2004 A në Shkollën “Motrat Qiriazit”, dhe të përsëritet votimi në ato vendvotime.

Në mbështetje të pretendimeve ankesës i ka bashkangjitur Deklaratat e vëzhgueseve, kopjen e Formularit të Rezultateve.

Subjekti politik LVV në përgjigjen në ankesë të datës 22.11.2017, ka theksuar se: pretenduesi nuk ka paraqitur asnjë provë të vetme dhe asnjë komisioner apo vëzhgues i subjektit politik nuk ka shkruar në librin e votimit në lidhje me ato pohime Përveç tjerash në këto vendvotime pretenduesi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo provë tjetër. Në argumentim të kësaj, Mirlinda Skeja me numër personal 2007440467 në cilësinë e komisionerës në vendvotimin 2004A/03r, ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë parregullsi në atë vendvotim. Ndërsa lidhur me pretendimin se vëzhguesja Sevim Budakova vendvotimin 2004A/06R, ka par parregullsi vëzhguesja në fjalë ka pasur mundësi që këto parregullsi ti shënoj në librin e votimit, mirëpo këtë nuk e ka bërë për shkak se nuk ka pasur kurrfar manipulimi edhe në këtë qendër të votimit. Ndërsa formular tregon saktë se Mytahir Haskuka ka marrë 262 vota, ndërsa kandidati tjetër Shaqir Totaj 102 vota. Për më tepër kryesuesja e këtij vendvotimi Vezire Koska ka deklaruar se “në vendvotimin nr. 2004A/06r, procesi zgjedhor ka qenë në rregull. Në argumentim të kësaj ajo deklaroi se pretendimet e Sevim Budakovës janë të pa baza dhe shpifje dhe se askush nuk ka votuar në emër të tjetër kujt dhe se fotografim të votës nuk ka pasur”.

Edhe për pretendimet ankuesit lidhur me parregullsitë në vendvotimin 2004A/03, 2004A/05R, nuk ka bashkangjitur asnjë provë të vetme, nga shiqimi i formularit konstatohet se për Mytahir Haskuka janë gjithsej 297 vota, ndërsa për Shaqir Totaj janë 96 vota. Ndërsa lidhur me vendvotimin 2004A/07R komisionerja ka deklaruar se i gjithë procesi i votimit ka vazhduar në qetësi të plotë pa asnjë vërejtje të deklaruar nga kryesuesi i subjektit tjetër, komisioner apo ndonjë votues.

Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur pesë deklarata dhe katër kopje të FPR-së.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se parashtruesi i ankesës me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e tij lidhur me parregullsitë në Shkollën “Motrat Qiriazit” në Lagjen Kurillë në Prizren në vendvotimet: 2004A/03r, 2004A/05r, 2004A/06r, 2004A/07r, sepse në librin e vërejtjeve nuk është shënuar asnjë parregullsi lidhur me pretendimet e anukuesit për parregullsi në ditën e votimit, duke u bazuar në nenin 94.1 të LZP-së i cili përcakton se *“Secili VV e ka Librin e Votimit në të cilin shënohen të gjitha ngjarjet domethënëse në lidhje me mbajtjen e votimeve të cilat ndodhin në vendvotim gjatë ditës së zgjedhjeve.*

Prandaj, nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në librat e votimit, ne Formularët e Përputhjes se Rezultateve (FPR), si dhe listat përfundimtare të votuesve nuk ka gjetur asnjë parregullsi apo ndërhyrje në këto materiale zgjedhore për vendvotimet e lartcekura, Paneli ankesën e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.1107/2017 më datën 22.11.2017.



Kryesuese e Panelit
Hasan Shala

Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*